



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Seanca konstituive e Kuvendit
P-01
Prishtinë, më 17 korrik 2014, në orën 10

P R O C E S V E R B A L

I SEANCËS KONSTITUIVE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 17 KORRIK 2014, E VAZHDUAR MË 18 SHTATOR DHE 8 DHJETOR
2014

Seancën konstitutive e kryesoi deputetja më e moshuar, Flora Brovina, kurse i ndihmoi deputetja më e re, Teuta Rugova.

Kryesuesja konstatoi se në seancë janë të pranishëm 120 deputetë dhe i hapi punimet e mbledhjes konstituive.

Kryesuesja, në fillim e përshëndeti presidenten e Republikës së Kosovës, zonjën Atifete Jahjaga, përfaqësuesin e BE-së, z. Samuel Zhibogar, ambasadoren e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, znj. Tracy Ann Jacobson, ambasadorët dhe përfaqësuesit e përfaqësive diplomatike në Kosovë, përfaqësuesit e bashkësive fetare në Kosovë, përfaqësuesit e medieve dhe të ftuarit tjerë që ishin të pranishëm.

Kryesuesja tha se Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e përbashkët me kryetarët e partive politike që kanë fituar vende në Kuvend, të mbajtur më 12 korrik 2014, ka përgatitur rendin e ditës për këtë mbledhje.

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Formimi i Komisionit të Përkohshëm për Verifikimin e Kuorumit dhe të Mandateve të Deputetëve,
2. Dhënia e betimit të deputetëve,
3. Njoftimi për formimin e grupeve parlamentare,
4. Zgjedhja e kryetarit dhe e nënkryetarëve të Kuvendit.

1. Formimi i Komisionit të Përkohshëm për Verifikimin e Kuorumit dhe të Mandateve të Deputetëve

Kryesuesja i ftoi partitë parlamentare që ta propozojnë nga një deputet në Komisionin për Verifikimin e Kuorumit dhe të Mandateve, i cili do ta shqyrtojë dokumentacionin përkatës të zgjedhjeve të 8 qershorit 2014 dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin lidhur me to.

Partitë parlamentare i propozuan anëtarët e Komisionit për Verifikimin e Kuorumit dhe të Mandateve, si vijon:

Deputeti Adem Grabovci, në emër të koalicionit PDK-PD-LB-PSHDK-PKK, e propozoi deputetin Memli Krasniqi.

Deputetja Vjosa Osmani, në emër të koalicionit LDK-AAK-NISMA, e propozoi deputetin Armend Zemaj.

Deputetja Donika Kadaj-Bujupi, në emër të AAK-së, tha se mbështesim propozimin për Armend Zemajn në këtë komision.

Deputeti Visar Ymeri, në emër të Lëvizjes “VETËVENDOSJE” e propozoi deputeten Albulena Haxhiu.

Deputetja Jasmina Zhivković, në emër të Listës serbe e propozoi deputeten Jelena Bontić.

Deputeti Mahir Yagcilar, në emër të KDTP-së, e propozoi deputeten Mufera Shinik.

Deputeti Rasim Demiri, në emër të koalicionit VAKAT, e propozoi deputeten Duda Balje.

Deputeti Nenad Rashiq, në emër të PDS-së, e propozoi deputeten Emilija Rexhepi.

Deputeti Danush Ademi, në emër të PDAK-ut, tha se meqenëse ky subjekt politik përfaqësohet vetëm nga ai në Kuvend, atëherë ai do të jetë anëtar i këtij komisioni.

Deputeti Veton Berisha, në emër të PLE-së, tha se meqenëse ky subjekt politik përfaqësohet vetëm nga ai në Kuvend, atëherë ai do të jetë anëtar i këtij komisioni.

Deputeti Etem Arifi, në emër të PAI, tha se meqenëse ky subjekt politik përfaqësohet vetëm nga ai në Kuvend, atëherë ai do të jetë anëtar i këtij komisioni.

Deputeti Adem Hoxha, në emër të koalicionit për Goren tha se përkrahin përfaqësuesin e Listës serbe në këtë komision.

Deputeti Kujtim Paçaku, në emër të KNRP-së, tha se meqenëse ky subjekt politik përfaqësohet vetëm nga ai në Kuvend, atëherë ai do të jetë anëtar i këtij komisioni.

Kryesuesja Flora Brovina i hodhi në votim propozimet e cekura më lart.

Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për ----- 120;

Kundër ----- 0;

Abstenime --- 0.

Kryesuesja konstatoi se Kuvendi i Kosovës njëzëri e zgjodhi Komisioni për Verifikimin e Kuorumit dhe të Mandateve.

Kryesuesja dha pauzë derisa komisioni ta shqyrtojë materialin përkatës zgjedhor.

* * *

Pas pauzës, në emër të Komisionit për Verifikimin e Kuorumit dhe të Mandateve, deputeti Memli Krasniqi, Kuvendit ia paraqiti raportin.

Ai tha se Komisioni i Përkohshëm për Verifikimin e Kuorumit dhe të Mandateve, në mbledhjen e mbajtur më 17 korrik 2014, e shqyrtoi dokumentacionin zgjedhor, si në vijim: Vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, të 7 korrikut 2014, për certifikimin e rezultateve të zgjedhjeve të mbajtura më 8 qershor 2014; listën e deputetëve të regjistruar në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe pas shqyrtimit të dokumentacionit zgjedhor, me tetë vota “për”, 1 “kundër dhe 1 “abstenim” konstatoi:

Në legjislaturën V të Kuvendit të Republikës së Kosovës janë certifikuar 120 deputetë nga subjektet politike, koalicionet, iniciativat qytetare që kanë marrë pjesë në zgjedhjet e 8 qershorit 2014, si vijon: PDK-PD-LB-PSHDK-PKK - 37 deputetë, LDK - 30 deputetë, “Vetëvendosje” - 16 deputetë, AAK - 11 deputetë, Lista Serbe - 9 deputetë, Nisma për Kosovën - 6 deputetë, KDTP - 2 deputetë, Koalicioni Vakut - 2 deputetë, PDS - 1 deputet, PDAK -1 deputet, NDS - 1, PLE - 1 deputet, PAI - 1 deputet, koalicioni për Gorën - 1 deputet, dhe KNRP - 1 deputet.

Komisioni konstatoi se në bazë të evidencës së deputetëve, në mbledhjen e sotme konstitutive të legjislaturës V janë të pranishëm 120 deputetë.

Komisioni i rekomandon Kuvendit që ta miratojë raportin për verifikimin e mandateve të deputetëve dhe t'i vazhdojë punimet sipas agjendës së paraparë dhe rregullave të procedurës, theksoi Memli Krasniqi.

Kryesuesja e hodhi në votim raportin e lartpërmendur.

Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për ----- 117;

Kundër ----- 0;

Abstenime --- 0.

Kryesuesja konstatoi se Kuvendi i Kosovës njëzëri miratoi raportin e Komisionit për Verifikimin e Kuorumit dhe të Mandateve.

2. Betimi i deputetëve të Kuvendit të Kosovës

Kryesuesja kërkoi nga deputetët që ta japin betimin solemn. Deputetët u ngritën në këmbë, kurse ajo lexoi tekstin e betimit, si vijon:

“Unë, deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, betohem se me nder e me përkushtim do ta kryej detyrën time dhe do ta përfaqësoj me dinjitet popullin, do të punoj në interes të Kosovës dhe të gjithë qytetarëve të saj, do të angazhohem për mbrojtjen dhe për respektimin e kushtetutshmërisë dhe të ligjshmërisë, për mbrojtjen e tërësisë territoriale dhe të integritetit institucional të Kosovës, për garantimin e lirive dhe të drejtave të njeriut, në përputhje me ligjet e vendit dhe me standardet evropiane”. Në fund, deputetët shqiptuan fjalën: “B e t o h e m i”!

3. Njoftimi për formimin e grupeve parlamentare

Kryesuesja tha se kjo çështje nuk është në kompetencë të sqarimit të saj dhe se kjo i takon kryetarit të Kuvendit të kësaj legjislature. Ajo këtë pikë e shtyu për mbledhjen tjetër.

4. Zgjedhja e kryetarit dhe e nënkryetarëve të Kuvendit

Kryesuesja, në mbështetje të nenit 67.2 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, të nenit 12. 2 të Rregullores së Kuvendit, si dhe të raportit të Komisionit të përkohshëm për verifikimin e kuorumit dhe të mandateve të deputetëve, kërkoi nga grupi më i madh parlamentar të propozojë kandidatin për kryetar të Kuvendit të Kosovës.

Deputeti Hajredin Kuçi, në emër të PDK-PD-LB-PSHDK-PKK, tha se sot kemi një dilemë lidhur me propozimin për kandidatë për kryetar të Kuvendit, nga dy palët - PDK-PD-LB-PSHDK-PKK dhe LDK- AAK- NISMA, se kush ka të drejtë të bëjë këtë propozim.

Ne, shtoi ai, kërkojmë që të kemi konsensus për dërgimin e kësaj çështjeje në Gjykatën Kushtetuese për të sqaruar këtë çështje. Ne do ta respektojmë cilindo vendim të Gjykatës Kushtetuese.

Deputetja Vjosa Osmani, në emër të Koalicionit LDK- AAK- NISMA, propozoi z. Isa Mustafa kandidat për kryetar të Kuvendit të Kosovës.

Deputetët e subjektit politik PDK-PD-LB-PSHDK-PKK, e lëshuan sallën.

Kryesuesja Flora Brovina dha pauzë deri në orën 13:00.

* * *

Pas pauzës kryesuesja, Flora Brovina kërkoi nga grupet parlamentare që t'i propozojnë kandidatët për kryetar të Kuvendit të Kosovës.

Deputeti Adem Grabovci, në emër të koalicionit PDK-PD-LB-PSHDK-PKK, propozoi deputetin Agim Aliun, kandidat për kryetar të Kuvendit të Kosovës.

Deputetja Vjosa Osmani, në emër të koalicionit LDK-AAK-NISMA e propozoi deputetin Isa Mustafën, kandidat për kryetar të Kuvendit të Kosovës.

Propozime të tjera nuk pati.

Deputetët e koalicionit LDK, AAK, NISMA dhe Lëvizjes” Vetëvendosje” dhe disa nga deputetët nga minoritetet e lëshuan sallën.

Kryesuesja konstatoi se në sallë janë të pranishëm 47 deputetë e në mungesë të kuorumit i mbylli punimet e mbledhjes së sotme në orën 13:10, ndërsa për vazhdimin e saj tha se do të njoftohen deputetët me shkrim.

* * *

Në vazhdim, mbledhjen e kryesoi deputetja Teuta Rugova.

Ajo tha se kemi një mocion për zëvendësimin e kryesueses së seancës së sotme konstituive, znj. Flora Brovina.

Ajo e hodhi në votim mocionin për zëvendësimin e kryesueses së mbledhjes konstitutive, znj. Flora Brovina.

Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për ----- 82;

Kundër ----- 0;

Abstenime --- 1.

Teuta Rugova konstatoi se Kuvendi i Kosovës e miratoi mocionin për zëvendësimin e kryesueses së seancës së sotme konstituive, zonja Flora Brovina.

Ajo më pas ftoi deputeten tjetër më të moshuar, Milka Vuletiq, që ta kryesojë këtë mbledhje konstituive.

Pasta, deputetja Milka Vuletiq e kryesoi mbledhjen dhe konstatoi se në sallë janë të pranishëm 82 deputetë.

Ajo procedoi me pikën numër katër të rendit të ditës:

- Zgjedhja e kryetarit dhe e nënkryetarëve të Kuvendit

Kryesuesja Milka Vuletiq e hodhi në votim propozimin për zgjedhjen e z. Isa Mustafa, kandidat për kryetar të Kuvendit të Kosovës.

Rezultati i votimit ishte:

Për ----- 65;

Kundër ----- 0;

Abstenime ---18.

Kryesuesja konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

PËR ZGJEDHJEN E KRYETARIT TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

1. Prof. dr. Isa Mustafa zgjidhet kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Kryesuesja, në mbështetje të nenin 67.3 dhe 67.4 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës dhe të nenit 12.3 dhe 12.5 të Rregullores së Kuvendit, kërkoi nga grupet më të mëdha parlamentare, që ta propozojnë nga një kandidat për nënkryetar të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Deputetja Vjosa Osmani, në emër të koalicionit LDK, AAK, NISMA, tha se kandidatin për nënkryetar do ta paraqesim në seancën e radhës.

Deputeti Visar Ymeri, në emër të Lëvizjes “VETËVENDOSJE”, për nënkryetar të Kuvendit të Republikës së Kosovës e propozoi deputetin Glauk Konjufca.

Kryesuesja e hodhi në votim propozimin për zgjedhjen e z. Glauk Konjufca, nënkryetar të Kuvendit.

Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për ----- 82;

Kundër ----- 0;

Abstenime ---- 0.

Kryesuesja konstatoi se Kuvendi i Kosovës, mori këtë:

V E N D I M

PËR ZGJEDHJEN E NËNKRYETARIT TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

1. Glauk Konjufca zgjidhet nënkryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës, nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje”.

* * *

Deputetja Jelena Bontiq, në emër të GP Lista serbe tha se kandidatin për nënkryetar do ta paraqesim në seancën e radhës.

Deputeti Mahir Yagcilar, në emër të komuniteteve jo shumicë dhe jo serb, për nënkryetar të Kuvendit të Republikës së Kosovës propozoi zgjedhjen me rotacion të deputetëve: Duda Balje, Mufera Shinik, Danush Ademi dhe Kujtim Paçaku.

Kryesuesja hodhi në votim propozimin për zgjedhjen e nënkryetarit të Kuvendit, nga komuniteteve jo shumicë dhe jo serb.

Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për ----- 80;

Kundër ----- 0;

Abstenime ---- 0.

Kryesuesja konstatoi se Kuvendi i Kosovës mori këtë:

V E N D I M

PËR ZGJIDHJEN E NËNKRYETARIT TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS NGA RADHA E KOMUNITETEVE JO SHUMICË

1. Duda Balje zgjidhet nënkryetare e Kuvendit të Republikës së Kosovës, nga radha e komunitetit boshnjak, me mandat një (1) vjeçar, deri më 16 korrik 2015.
2. Mufera Shinik, nga radha e komunitetit turk, me mandat një (1) vjeçar, prej 17 korrikut 2015 deri më 16 korrik 2016.
3. Danush Ademi, nga radha e komunitetit ashkali, me mandat një (1) vjeçar, prej 17 korrikut 2016 deri më 16 korrik 2017.
4. Kujtim Paçaku, nga radha e komunitetit rom, me mandat një (1) vjeçar, prej 17 korrikut 2017 deri më 16 korrik 2018.

* * *

Në fund, kryetari i zgjedhur, Isa Mustafa, i falënderoi deputetët e Kuvendit për besimin e dhënë. Ai tha se Kuvendi gjatë legjislaturës V, në bashkërendim me institucionet e tjera, do ta realizojë rolin e tij kushtetues.

Fjala e z. Isa Mustafa është dhënë e plotë në transkript.

Kryetari Isa Mustafa e deklaroi mbledhjen të mbyllur në orën 13:55 minuta.

Shënim: Gjykata Kushtetuese, me kërkesë të deputetit Xhavit Haliti dhe të 29 deputetëve të tjerë në rastin nr.KO119/14, më 26 gusht 2014 kishte

VENDOSUR

- Vendimi i Kuvendit, nr. 05-V-001, më 17 korrik 2014 është jokushtetues,
- Seanca konstituive e Kuvendit, që ka filluar më 17 korrik 2014, nuk është realizuar plotësisht, konkretisht nuk është zgjedhur kryetari dhe nënkryetarët e Kuvendit.

E enjte, 18 shtator 2014

Vazhdimi i seancës konstituive

Mbledhjen e drejtoi kryesuesja, Flora Brovina, ndërsa i ndihmoi deputetja më e re, Teuta Rugova.

Kryesuesja deklaroi të hapur vazhdimin e punimeve të mbledhjes konstituive të filluar më 17 korrik 2014.

Kryesuesja, në pajtim me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, rasti KO 119/14, më 26 gusht 2014, procedoi me mbledhjen konstituive të Legjislaturës V, të filluar më 17 korrik 2014, me pikën:

1. Zgjedhja e kryetarit dhe e nënkryetarëve të Kuvendit

Kryesuesja i njoftoi deputetët se në bazë të pikës c të aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese për rastin KO 119/14, më 26 gusht 2014, seanca konstituive e Kuvendit, që ka filluar më 17 korrik 2014, nuk është realizuar plotësisht, konkretisht nuk janë zgjedhur kryetari dhe nënkryetarët e Kuvendit. Rrjedhimisht, Kuvendi duhet ta përfundojë seancën konstituive, duke zgjedhur kryetarin dhe nënkryetarët, në pajtim me nenin 67, pika 2 dhe në lidhje me nenin 64, pika 1 e Kushtetutës dhe me Kreun III të Rregullores që i zbaton këto nene dhe në pajtim me këtë aktgjykim.

Andaj, në bazë të nenit 67, paragrafi 2, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në pajtim me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, ajo ftoi përfaqësuesin e Koalicionit PDK-PD-LB-PSHDK dhe PKK që ta propozojë kandidatin për kryetar të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Hajredin Kuçi, në emër të PDK-PD-LB-PSHDK - PKK propozoi deputetin Arsim Bajramin.

Kryesuesja kërkoi nga deputetët që me ngritje të dorës të deklarojnë për kandidatin e propozuar.

Rezultati i votimit ishte si në vijim:

Për 44,
Kundër 61,
Abstenime11.

Kryesuesja Flora Brovina konstatoi se kandidati i propozuar nga Koalicionit PDK-PD-LB-PSHDK - PKK nuk i mori votat e mjaftueshme për t'u zgjedhur kryetar i Kuvendit.

Kryesuesja e mbylli mbledhjen e sotme dhe shtoi se deputetët do të njoftohen me shkrim për vazhdimin e seancës konstituive.

* * *

E hënë, 8 dhjetor 2014

Vazhdimi i seancës konstituive

Mbledhjen e drejtoi kryesuesja e Kuvendit, Flora Brovina, ndërsa i ndihmoi deputetja më e re, Teuta Rugova.

Kryesuesja deklaroi të hapur vazhdimin e punimeve të mbledhjes konstituive të filluar më 17 korrik 2014 dhe të vazhduar më 18 shtator 2014.

Kryesuesja procedoi me pikën e rendit të ditës:

1. Zgjedhja e kryetarit dhe e nënkryetarëve të Kuvendit

Kryesuesja i njoftoi deputetët se në bazë të pikës c të aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese për rastin KO 119/14, më 26 gusht 2014, seanca konstituive e Kuvendit, që ka filluar më 17 korrik 2014 dhe e vazhduar më 18 shtator 2014, nuk është realizuar plotësisht, konkretisht nuk janë zgjedhur kryetari dhe nënkryetarët e Kuvendit.

Kryesuesja, në bazë të nenit 67, paragrafi 2, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në pajtim me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, ftoi përfaqësuesin e Koalicionit PDK-PD-LB-PSHDK-PKK që ta propozojë kandidatin për kryetar të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Deputeti Hajredin Kuçi, në emër të Koalicionit PDK-PD-LB-PSHDK-PKK, e propozoi deputetin Kadri Veselin, kandidat për kryetar të Kuvendit, ndërsa për nënkryetar të Kuvendit e propozoi deputetin Xhavit Halitin.

Kryesuesja, në vazhdim kërkoi nga përfaqësuesit e grupeve parlamentare që të paraqesin kandidatët për nënkryetar të Kuvendit.

Deputeti Ismet Beqiri, në emër të GP LDK-së, për nënkryetar të Kuvendit e propozoi deputetin Sabri Hamiti.

Deputeti Visar Ymeri, në emër të GP VV, për nënkryetar të Kuvendit e propozoi deputetin Glauk Konjufcën.

Deputeti Bojan Mitiq, në emër të GP Lista Serbe, për nënkryetar të Kuvendit e propozoi deputeten Jasmina Zhivković.

Deputeti Mahir Yagcilar, në emër GP "6+" për nënkryetar të Kuvendit propozoi që të zgjidhen me rotacion këta deputetë: deputetja Duda Balje, nga radha e komunitetit boshnjak, për periudhën 8 dhjetor 2014 - 7 shkurt 2016, në periudhën 8 shkurt 2016 - 7 prill 2017, nga radha e komunitetit turk, deputeti Danush Ademi, nga radha e komunitetit ashkali, për periudhën 8 prill 2017 - 7 nëntor 2017 dhe deputeti Kujtim Paçaku, nga radha e komunitetit rom, në periudhën 8 nëntor 2017 - 7 qershor 2018.

Pastaj, kryesuesja kërkoi nga deputetët që me ngritje të dorës të deklarohen për kandidatin për kryetar të Kuvendit.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për 71,
Kundër42,
Abstenime 1.

Kryesuesja konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

PËR ZGHJEDHJEN E KRYETARIT TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

1. Deputeti Kadri Veseli zgjidhet kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Në vazhdim kryesuesja, hodhi në votim propozimet për nënkryetarë të Kuvendit, nga tri grupet më të mëdha parlamentare, PDK, LDK dhe VV.

Rezultati i votimit ishte si në vijim:

Për 98,
Kundër 2,
Abstenime 15.

Kryesuesja konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

PËR ZGJEDHJEN E NËNKRYETARËVE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

1. Deputeti Xhavit Haliti, nga GP i PDK-së, zgjidhet nënkryetar i Kuvendit.

2. Deputeti Sabri Hamiti, nga GP i LDK-së, zgjidhet nënkryetar i Kuvendit.
3. Deputeti Glauk Konjufca, nga GP i LVV, zgjidhet nënkryetar i Kuvendit.

Në vazhdim kryesuesja, hodhi në votim propozimet për nënkryetarë të Kuvendit, nga GP Lista serbe dhe GP “6+”.

Rezultati i votimit ishte si në vijim:

Për 75,
Kundër19,
Abstenime 20.

Kryesuesja konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

PËR ZGJEDHJEN E NËNKRYETARËVE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS NGA RADHA E KOMUNITETEVE JO SHUMICË

- I. Deputetja Jasmina Zhivković, nga radha e komunitetit serb, zgjidhet nënkryetare e Kuvendit.
- II. Nënkyetari i Kuvendit, nga radhët e komuniteteve tjera jo shumicë, zgjidhet me rotacion, si në vijim:
 1. Deputetja Duda Balje, nga radha e komunitetit boshnjak, zgjidhet nënkryetare e Kuvendit, për periudhën 8 dhjetor 2014 - 7 shkurt 2016.
 2. Për periudhën 8 shkurt 2016 -7 prill 2017, nënkryetari i Kuvendit do të jetë deputeti nga radha e komunitetit turk.
 3. Deputeti Danush Ademi, nga radha e komunitetit ashkali, zgjidhet nënkryetar i Kuvendit, për periudhën 8 prill 2017 - 7 nëntor 2017.
 4. Deputeti Kujtim Paçaku, nga radha e komunitetit rom, zgjidhet nënkryetar i Kuvendit, për periudhën 8 nëntor 2017 - 7 qershor 2018.

* * *

Në vazhdim, kryesuesja ftoi kryetarin dhe nënkryetarët e Kuvendit të ulen në ulëset e tyre.

Kryetari i Kuvendit z. Kadri Veseli i falënderoi të gjithë deputetët e Kuvendit për besimin e dhënë.

Në vazhdim, kryetari tha se duke i falënderuar së pari familjet e shenjta, mbi supet e të cilave është ngritur liria jonë, familjet e dëshmorëve, si themelet e lirisë dhe pavarësisë së Republikës së Kosovës, për të gjithë ne këtu dhe të gjithë qytetarët e kësaj republike, Adem Jashari është inspirim dhe sinonim sublim i vlerave më të shenjta lirisdashëse. Ushtria Çlirimtare e Kosovës ishte kapitulli i fundit, por më i rëndi dhe më i rëndësishmi i betejës sonë shekullore për liri dhe shtet. E shfrytëzoj rastin ta përmend edhe rezistencën paqësore dhe veprën e presidentit të ndjerë Ibrahim Rugova që arriti t'i mobilizojë të gjitha shtresat e shoqërisë kosovare me kërkesën për liri dhe pavarësi të vendit tonë.

Kuvendi do të jetë vend i debateve gjithëpërfshirëse dhe i kompromiseve, e jo i metodave dhe gjuhës përjashtuese. Unë, si kryetari juaj i zgjedhur, me devotshmëri do ta respektoj fjalën tuaj si deputetë të nderuar, të opozitës dhe pozitës. Do të angazhohem që debatet tona pozitive-opozitive të jenë mbi politikën ditore, mbi mosmarrëveshjet personale, por në angazhimin në interes të vendit.

Ky do të jetë një fillim i ri, një fazë e re dhe një mision i ri, por kemi edhe kontinuitet të pashlyeshëm, i cili qëndron në vlerat tona që i kemi përqafuar kur kemi rezistuar dhe luftuar për liri dhe për ta ndërtuar Kosovën e pavarur, si pjesë e vlerave euroatlantike, vlera të cilat janë betonuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Këto vlera bazohen në shtetin e së drejtës, në demokracinë parlamentare të shoqërisë sonë, që bashkërisht të punojmë drejt së mirës së vendit tonë.

Ne duhet të gjithë bashkërisht të angazhohemi fuqimisht që ta vazhdojmë traditën si një vend tolerant dhe një shembull global i bashkëjetesës ndërfetare dhe ndëretnike. Kjo është një pasuri e Kosovës, të cilën ne duhet ta respektojmë dhe kultivojmë pa dallim partiak dhe ta ruajmë si vlerë kombëtare. Do të punojmë fuqimisht që pakicat e Kosovës të mos jenë asnjëherë të rrezikuara nga shumica.

Puna jonë e përbashkët për ta ndërtuar një Kosovë demokratike do të pasqyrohet në përkushtimin e secilit prej nesh në këtë Kuvend dhe qindra-mijëra njerëzve anekënd vendit tonë që na përcjellin sot aktualisht, që qysh nga dita e nesërme të jemi edhe më të bashkuar, të jemi edhe më solidarë, duke trasuar mbi rrugën që e kaluan shumë gjenerata deputetësh para nesh. Fjala e plotë e kryetarit është dhënë në transkript.

Kryetari i mbylli punimet e seancës konstituive në orën 12:50 minuta.

Kryesuesja e mbledhjes konstituive

Flora BROVINA

E përgatiti:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale